



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:051791
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05624383
P.nr.83/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lulzim Paçarizi me sekretaren juridike Behije Karaçica, në lëndën penale kundër të akuzuarit G.K., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënparag.2.1 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP.II.nr.149/23 të datës 06.07.2023, në shqyrtimi fillestar të mbajtur më datë 16.04.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Qazim Kuqi, të akuzuarit G. K., si dhe mbrojtësit të tij Av. Agron Kryeziu, sipas autorizimit me dt. 18.04.2024, merr ndërsa me dt. 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: G.K., nga i ati H. dhe e ëma H. e lindur Z., i lindur me datë ... në fshatin T. komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i R. Të Kosovës, martuar, ati i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 31.05.2022 në lokalit të tij restaurant „N.T.H B.” në M., me qëllim që vetit t’i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë në kundërshtim me Ligjin për Energji Elektrike të Republikës së Kosovës Nr.05/L-085, në atë mënyrë që gjatë kontrollës së realizuar në njehsorin elektrik me numër ... është konstatuar se i pandehuri në katin e III të restaurantit e ka të kyçur një kabllo 4x16 mm jashtë pikës matëse, dhe me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast të dëmtuarës K.-distrikti në Gj. i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 8,161.56 Euro.

- me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar. 2.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 par.1 pika 1.3, nenit 315 par.2 nënparag.2.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës të njëjtin e:

G J Y K O N

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **një (1)** viti, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar me burgim nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej dy (2) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

URDHËROHET Shërbimi Sprovës i Kosovës në Gj. që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gj..

E dëmtuara K.- distrikti në Gj., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor që të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet euro) , të gjitha këto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë- Departamenti i përgjithshëm me dt. 06.07.2023 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.149/23, kundër të akuzuarit G.K., , nga fsh. Turjakë K. Malishevë, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2. I të KPRK-së, dhe se bashku me aktakuzë kanë paraqitur edhe marrëveshjen e pranimit të fajësisë PP.nr.149/23 të dt. 22.05.2023 të arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të pandehurit G.K., me mbrojtësin e tij av. Agron Kryeziu me autorizim, në anën tjetër.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimit të fajësisë me datën 16.04.2024, dhe ka ftuar Prokurorinë e Shtetit, të akuzuarin G.K., dhe mbrojtësin e tij av. Agron Kryeziu me autorizim, nuk ka prezantuar përfaqësuesi i të dëmtuarit edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, kësaj gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siç e parasheh edhe neni 230 par.17 të KPP-së.

I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet në konsultim me mbrojtësin, dhe se pajtohet me këtë marrëveshje për pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit Qazim Kuqi ka theksuar se: Pranë kësaj gjykate është sjellë marrëveshja e arritur midis prokurorisë së shtetit dhe këtu të akuzuarit G.K., në prezencë të mbrojtësit të tij Av. Agron Kryeziu, sipas marrëveshjes PP.nr. 149/23, e dt.22.05.2023, për të cilën marrëveshje për kushtet e llojin e dënimit është e njoftuar kjo gjykatë si dhe vet i akuzuari i cili është palë në këtë marrëveshje. Andaj, përveç

kushteve të caktuara në këtë marrëveshje ne si prokuror i nuk kemi çka të shtojmë dhe i propozon gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet dhe të jetë pjesë e shkresave të lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. Agron Kryeziu ka deklaruar: Konfirmojmë se me dt. 22.05.2023, unë bashkë me klientin tim jemi paraqitur në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për të realizuar takimin fillestar lidhur me diskutimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe ne te njëjtën ditë bashkë me prokurorin e çështjes Anton Hasanaj, si dhe me Kryeprokurorin në Gjakovë kemi arritur marrëveshje për të cilën paraprkisht unë dhe i mbrojturi im morëm kohën e mjaftueshëm për këshillim, sqarim të te drejtave dhe obligimeve dhe pasi që jam bindur se ajo çfarë shkruan në marrëveshje është vullneti i të mbrojturit tim i cili derivon pas konsultave të mjaftueshme dhe plotësohen të gjitha kushtet ligjore, kemi lidhë këtë marrëveshje të cilën e pranojmë në tërësi. Kemi lenë një hapësirë që do ta vërej gjykata tek dënimi që gjykatës ti drejtohem me kërkesë që maksimalisht të pranohet ë dakorduar dhe këto rrethana i kemi sqaruar edhe tek prokurori i çështjes dhe eprori i tij, nën prezumimin se gjykata do na lejoj edhe njëherë ti adresohemi për këtë çështje pas vendimit për pranim apo jo të marrëveshjes rezervojmë të drejtën që edhe një herë ti drejtohem gjykatës për të shpalosur rrethanat personale me rëndësi për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Përfundimisht kjo është marrëveshja që ne e kemi dakorduar dhe ne rast se pranohet nga gjykata heqim dorë që të njëjtën ta kontestojmë për çfarë shkak apo arsye.

Gjykata pasi shqyrtoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe pasi konstatoi se nuk ka ndonjë pengesë ligjore për aprovimin e saj, ka nxjerrë aktvendim me të cilën e ka aprovuar këtë marrëveshje për pranim të fajësisë PP.II.nr.149/23 të datës 22.05.2023, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjorë për një gjë të tillë konform 230 të KPP-së. Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se i akuzuari i kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë rrethanë të parapara në nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së. Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se palët e kësaj marrëveshje për pranimin e fajësisë kanë hequr dorë nga shqyrtimi gjyqësor për t'u shqyrtuar kjo çështje juridike penale, si dhe të gjitha të drejtat tjera lidhur me shqyrtimin gjyqësor dhe i kanë propozuar gjykatës për aprovim të saj.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë; Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike me numër ..., datë 31.05.2022, fatura mbi kalkulimin e rikthimit të humbjeve me nr.D. dt.31.05.2022, deklarata e të pandehurit G.K., , e dhënë në prokurori me dt.03.05.2023, fotografitë si dhe shkresat tjera në lëndë.

Nga veprimet e të akuzuarit, përmbushën të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1. 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për të cilin i akuzuari u shpall fajtor dhe i'u shqiptua dënimi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar dhe ka aprovuar rekomandimin për dënimin të paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit dhe të shqiptohet dënimi me kusht në kohëzgjatje prej një (1) viti burgim, të cilin dënim gjykata nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej dy (2) viteve nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, duke e konsideruar si dënim të drejtë dhe duke vlerësuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat e nenit 69, 70, 71 dhe 72 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, ashtu që për të pandehurin ka marr faktin se i njëjti ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në një fazë të hershme të procedurës penale duke i shfrytëzuar benifitet të cilat parashihen në dispozitat e KPP-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin vlerësoj faktin se ka arritur marrëveshje për pranim të fajësisë, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të këtë kujdes dhe nuk do të përsërisë vepra të tilla, është penduar për këtë veprë penale, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, mban familjen me punë në sektorin privat, gjithashtu gjyqtari vetëm gjykues vlerëson se me shqiptimin e dënimit sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 2 nënparag.2.1 të KPRK-së, ia shqiptoj dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ndërsa gjykata dënimin kohorë me burgim nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 2 (dy) viteve nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, me bindje se ky dënim është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojnë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.83/23, me dt.18.04.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

Numri i lëndës: 2023:051791
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05624383

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.